

GJYKATA E APELIT
PRISHTINË

Numri i lëndës: PAKR 349/14

Më: 22 korrik 2015

Gjykata Themelore: Prizren, P 171/13

Originali: **Anglisht**

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Piotr Bojarczuk, kryetar, dhe gjyqtarëve kosovar Abdullah Ahmeti dhe Dr. Driton Muharremi si anëtarë të kolegjit, me asistimin e Dr. Bernd Franke, zyrtar ligjor i EULEX-it, i cili vepron në cilësinë e procesmbajtësit,

në lëndën penale kundër të pandehurve:

1. **R.M.**, emri i të atit [...]; i lindur më [...] në [...], shqiptar i Kosovës, adresa aktuale - [...];
2. **S.P.**, emri i të atit [...], i lindur më [...], në fshatin [...], shqiptar i Kosovës, adresa aktuale [...];
3. **A.A.**, emri i të atit [...], i lindur më [...], shqiptar i Kosovës, adresa aktuale [...];
4. **K.U.**, emri i të atit [...], i lindur më [...] në fshatin [...], shqiptar i Kosovës, adresa aktuale [...];

5. **A.T.**, emri i të atit [...], i lindur më [...] në fshatin [...], shqiptar i Kosovës, adresa aktuale [...];
6. **M.K.**, emri i të atit [...], i lindur më [...] në fshatin [...], shqiptar i Kosovës, adresa aktuale [...].

Të gjithë të akuzuar sipas aktakuzës së datës 26 shkurt 2013, e ngritur pranë Gjykatës Themelore në Prizren më 27 shkurt 2013 për këtë vepër penale:

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 paragrafi 1, 2 nën-paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Kodit Penal në fuqi nga data 1 janar 2013 e në vazhdimësi, në përputhje me nenin 81 në fuqi nga 1 janar 2013, dhe pjesërisht në bashkëkryerje sipas nenit 31 të Kodit Penal në fuqi nga 1 janar 2013;

e gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata Themelore me aktgjykimin P. nr. 171/13, të datës 13 mars 2014, me të cilin të pandehurit janë shpallur fajtor dhe dënuar si në vazhdim:

1. R.M.

Në përputhje me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 81 dhe nenin 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga data 1 janar 2013 me dënim prej 2 vjet burgim me kusht, sipas nenit 51 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga data 1 janar në periudhë verifikimi prej (3) vjet nëse i pandehuri nuk kryen asnjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Sipas nenit 65 paragrafi 2 Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga data 1 janar 2013, me dënim të ndalimit për të ushtruar funksione në administratën publike ose në shërbim publik për tridhjetë (30) muaj.

2. S.P.

Në përputhje me nenet 34, 42, 43, 44, 64 dhe nenin 339 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga data 1 janar 2013 me dënim prej tetë (8) muaj burgim me kusht, sipas nenit 43

paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga data 1 janar 2013 në periudhë verifikimi prej dy (2) vjet nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë kësaj periudhe të njëjtë.

Sipas nenit 65 paragrafi 2 Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga data 1 janar 2013, me dënim të ndalimit për të ushtruar funksione në administratën publike ose në shërbim publik për dymbëdhjetë (12) muaj.

3. A.A.

Në përputhje me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 75, 76 dhe nenin 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga data 1 janar 2013 me dënim prej pesë (5) muaj burgim me kusht, sipas nenit 51 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janar 2013 për periudhë verifikimi prej tetëmbëdhjetë (18) muaj nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

4. K.U.

Në përputhje me nenet 33, 41, 49, 50, 52, 73, 74, 75 dhe nenin 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga data 1 janar 2013 me dënim prej tetë (8) muaj burgim me kusht, sipas nenit 51 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janar 2013 për periudhë verifikimi prej njëzet (20) muaj nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

5. A.T.

Në përputhje me nenet 25, 34, 42, 43, 44, 64, 65 dhe nenin 339 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga data 1 janar 2013 me dënim prej një (1) muaj burgim me kusht, sipas nenit 43 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi prej 1 janar 2013 në periudhë verifikimi prej një (1) viti nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë tjetër vepër penale gjatë kësaj periudhe të njëjtë.

6. M.K.

Në përputhje me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 81 dhe nenin 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga data 1 janar 2013, me dënim prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim me kusht, sipas nenit 51 paragrafi 2.1 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi prej 1 janar 2013 në periudhë

verifikimi prej dy (2) vjet nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë tjetër vepër penale gjatë kësaj periudhe të njëjtë. Sipas nenit 65 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi prej 1 janar 2013, me dënim për të ushtruar funksione në administratën publike ose në shërbim publik për tetëmbëdhjetë (18) muaj.

Përveç kësaj ndaj të pandehurve ishte caktuar që të paguanin të gjitha shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 1,200 euro. Obligimi i çdo të pandehuri ka qenë i kufizuar në shumën prej 200 euro secili. Përveç kësaj, sipas nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së, Ministria e Drejtësisë, Komuna e Prizrenit, Agjencia Kosovar e Privatizimit dhe Organizata e Pylltarisë 'Sharri' janë udhëzuar të paraqesin kërkesën e tyre pronësore juridike në kontest civil;

pas shqyrtimit të ankesave të parashtruara nga avokati mbrojtës Ruzhdi Berisha në emër të **R.M.** më 27 maj 2014, nga avokati mbrojtës Sahit Bibaj në emër të **S.P.** më 26 maj 2014, nga avokati mbrojtës Rexhep Hasani në emër të **A.A.** më 26 maj 2014, nga avokati mbrojtës Brahim Sopa në emër të **K.U.** më 20 maj 2014, nga avokati mbrojtës Skender Morina në emër të **A.T.** më 20 maj 2014 dhe nga avokatët mbrojtës Pjetër Pergjoka dhe Bashkim Nevzati në emër të **M.K.** më 28 maj 2014, të gjitha kundër aktgjykimit P. nr. 171/13, të sjellë nga Gjykata Themelore e Prizrenit më 13 mars 2014;

pas marrje parasysh të përgjigjes së prokurorit Danilo Ceccarelli në emër të Zyrës së Prokurorisë së EULEX-it, e parashtruar më 8 korrik 2014;

pas marrjes në konsideratë të propozimit të prokurorit të apelit të shtetit, Judit Eva Tatrai, i parashtruar më 4 shtator 2014;

pas mbajtjes së seancës të hapur për publikun të Gjykatës së Apelit më 9 qershor 2015;

pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 22 korrik 2015;

duke vepruar në përputhje me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 402 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP);

merr këtë:

AKTVENDIM

1. Pranohet ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës Ruzhdi Berisha në emër të R.M. më 27 maj 2014, ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës Sahit Bibaj në emër të S.P. më 26 maj 2014, ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës Rexhep Hasani në emër të A.A. më 26 maj 2014, ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës Brahim Sopa në emër të K.U. më 20 maj 2014, ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës Skender Morina në emër të A.T. më 20 maj 2014 si dhe ankesat e parashtruara nga avokatët mbrojtës Pjetër Pergjoka dhe Bashkim Nevzati në emër të M.K. më 28 maj 2014, ndërsa anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prizrenit P. nr. 171/13, i lëshuar më 13 mars 2014;

Lënda kthehet në Gjykatën Themelore të Prizrenit për rigjykim.

ARSYETIM

I. HISTORIA E PROCEDURËS

Më 15 shtator 2011, prokurori nga Zyra e Prokurorisë së Qarkut ka nxjerrë aktvendimin mbi inicimin e hetimit me numër referues HP. nr. 147/2011 më 15 shtator 2011 kundër **R.M.**, **N.K.**, **S.P.** dhe **A.A.** të gjithë këta të hetuar për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit sipas nenit 339 të Kodit Penal të Kosovës, tash e tutje në tekst “KPK”.

Më 26 shtator 2011, ushtruesi i detyrës së prokurorit të qarkut në Prizren, Sylë Hoxha, ka parashtruar kërkesë në Zyrën e Prokurorisë së EULEX-it në Prizren që lënda të merret nga

EULEX-i për shkak të faktit se e njëjta kishte të bënte me zyrtar të lartë të komunës dhe se lënda konsiderohej të ishte shumë e ndjeshme.

Prokurori vendor ka nxjerr aktvendimin mbi iniciimin e hetimit HP. nr. 255/2011 kundër **R.M., K.U., A.A.** dhe **A.T.** më 29 shtator 2011 për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit sipas nenit 339 të KPK-së.

Ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të EULEX-it ka marr vendim për ta marrë lëndën dhe për të ia caktuar një prokurori të EULEX-it për hetime të mëtejme më 3 tetor 2011.

Pas shqyrtimit të provave, prokurori ka lëshuar një aktvendim tjetër për iniciimin e hetimit (PPN. nr. 204/11) kundër **R.M.** më 14 nëntor 2011, për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit sipas nenit 339 të KPK-së.

Prokurori i EULEX-it më 14 nëntor 2011 ka parashtruar një propozim në gjykatë për t'i kombinuar hetimet PP. nr. 147/2011, HP Nr. 255/2011 dhe PPN nr. 204/11 kundër të gjithë të pandehurve dhe për të vazhduar me një procedurë të vetme hetimore.

Kolegji i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës së Qarkut në Prizren ka nxjerr aktvendimin Kp. nr. 407/2011 më 18 nëntor 2011, me të cilin ata vendosën që të zbatohet një procedurë e vetme për të tri hetimet dhe se rasti do të vazhdojë me numër të lëndës Hep. nr. 147/2011.

Prokurori i ka parashtruar propozim kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it më datë 23 nëntor 2011, për të ua caktuar lëndën gjyqtarëve të EULEX-it dhe më 4 janar 2012 kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it ka nxjerr vendimin JC/EJU/OPEJ/2697/ff/11 duke vendosur që lëndën t'ia caktojë njësisë së gjyqtarëve të EULEX-it në Prizren.

Prokurori i EULEX-it ka marr vendimin mbi zgjerimin e hetimit ndaj **R.M., N.K., S.P., A.A., K.U., A.T.** dhe **M.K.** më 14 mars 2012.

Prokurorja e sapoemëruar e lëndës Natasha Vicary mori tri aktvendime të ndara për ndërprerjen e pjeshme të hetimit më 20 shkurt 2013 në lidhje me **R.M.**, **N.K.** dhe **A.A.** për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 të KPP-së (Kodi i ri i penal).

Prokurori i lëndës ka ngritur aktakuzën kundër **R.M.**, **S.P.**, **A.A.**, **K.U.**, **A.T.** dhe **M.K.** më 27 shkurt 2013, për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 të KPP-së, për katër pika ashtu sikurse është shpjeguar në aktakuzë.

Shqyrtimi fillestar u mbajt në praninë e të pandehurve, avokatëve mbrojtës dhe prokurorit më 25 mars 2013. Pas parashtrimit të kundërshtimeve nga avokatët mbrojtës, gjyqtari ka sjell aktvendimin mbi refuzimin e kundërshtimeve dhe ka vendosur që lëndën ta dërgojë në shqyrtim gjyqësor.

Aktvendimi u ankimua në Gjykatën e Apelit dhe pas shqyrtimit, e njëjta gjykatë më 29 maj 2013, solli aktvendimin PN. nr. 372/13 duke e prishur aktvendimin e kryetarit të trupit gjykues dhe lëndën e ktheu në rivendosje.

Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit, ky kryetar i trupit gjykues pas rivendosjes, ka lëshuar një tjetër aktvendim më 14 qershor 2013 duke e kthyer lëndën prapa në shqyrtimin gjyqësor. Pas kundërshtimeve të parashtruara nga avokatët mbrojtës dhe pas paraqitjes së mendimit të prokurorit më 25 korrik 2013, Gjykata e Apelit solli aktvendimin me të cilën konfirmoi aktvendimin e kryetarit të trupit gjykues dhe dërgimin e lëndës në shqyrtimin gjyqësor.

Shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë ka filluar më 13 gusht 2013 dhe pas mbajtjes së 28 seanceve, trupi gjykues shpalli aktgjykimin më 13 mars 2014.

Aktgjykimi është ankimuar nga avokati mbrojtës Ruzhdi Berisha në emër të **R.M.**, nga avokati mbrojtës Sahit Bibaj në emër të **S.P.**, nga avokati mbrojtës Rexhep Hasani në emër të **A.A.**, nga avokati mbrojtës Brahim Sopa në emër të **K.U.**, nga avokati mbrojtës Skender Morina në emër të **A.T.** dhe nga avokatët mbrojtës Pjetër Pergjoka dhe Bashkim Nevzati në emër të **M.K.**

Seanca e kolegjit të apelit është mbajtur më 9 qershor 2015 në praninë e të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës. Prokurori i apelit i shtetit nuk ka qenë i pranishëm.

Kolegji është këshilluar dhe ka votuar më 22 korrik 2015.

II. PARASHTRESAT E PALËVE

1. **Avokati mbrojtës Ruzhdi Berisha në emër të profesor R.M.** më 27 tetor 2014 ka parashtruar ankesën e datës 27 tetor 2014 pranë Gjykatës Themelore për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 384 i KPP-së);
- Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 386 i KPP-së);
- Shkeljes së ligjit penal (neni 385 i KPP-së);
- Vendimit të gabuar mbi sanksionin penal (neni 387 i KPP-së).

Mbrojtja paraqet se aktgjykimi nuk është në përputhje me nenin 365 dhe 370, paragrafët 3, 4 dhe 7 të KPP-së. Dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe është plotësisht i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me brendinë e tij. Është e paqartë nëse faktet e aktakuzës janë bërë pjesë e hyrjes apo dispozitivit të aktakuzës. Në vend të paraqitjes së fakteve për të cilat të akuzuarit u shpallën fajtor, dispozitivi u referohet pikave të aktakuzës. Aktgjykimi nuk përmban arsyetim në lidhje me *dashjen* specifike për të përfituar dobi pasurore, për të shkaktuar dëm ose për të cenuar në mënyrë të rëndë të drejtat e një personi tjetër. Shkelja e ligjit *per se* pa dashje specifike nuk përbën vepër penale.

Në lidhje me pikën 1, i pandehuri nuk i ka njohur të gjithë personat të cilët kanë përfituar nga vepra penale. Në pikën 2, pala e dëmtuar e cila ka pësuar dëmin është një organizatë jo ekzistuese. Në pikën 3, organizata që ka përfituar është një investitor i huaj. Lidhur me pikën 4, asnjëri nga këta që ka pësuar shkelje të të drejtave të tyre, nuk ka parashtruar mjet.

Ai pohon se mbajtja e të dhënave të kadastrit nuk është obligim apo kompetencë e kryetarit të komunës. Duke iu referuar nenit 58 të Ligjit mbi qeverisjen lokale dhe nenit 50 të statutit të Komunës së Prizrenit, ndryshimet në regjistrin e kadastrit nuk janë obligim i kryetarit të komunës. Për këtë arsye ai nuk do të kishte mundur ta kryej këtë vepër penale duke mos arritur të përmbush detyrat e tij zyrtare nën kompetencat e veta. Sido që të jetë shërbyesit civil nuk

duhet assesi të zbatojnë urdhrat dhe udhëzimet e mbikëqyrësve të vet nëse ato janë në kundërshtim me ligjin.

Lidhur me pikën 1, ai vëren se për shkak të pengesave ligjore dhe gabimeve teknike ka qenë e pamundur të ekzekutohet vendimi i Gjykatës Supreme dhe të regjistroheshin ndryshimet e pronësisë së ngastrave me numër 8617 dhe 8619 në të dhënat kadastrale. Dispozitivi i vendimit nuk u referohet fare parcelave d.m.th. ngastrës nr. 8618. Së dyti, vendimi është i gabueshëm në fakte. Së treti, i pandehuri nuk ka qenë kryetar i komunës së Prizrenit kur i është dorëzuar aktgjykimi.

Më pas më 17 nëntor 2006, komuna e Prizrenit ka urdhëruar rigjykimin e të njëjtës çështje, procedurë e cila mori formën e prerë me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit më 2 prill 2007. Propozimi për rishikim i parashtruar nga avokati i komunës ishte hedhur poshtë nga Gjykata Supreme më 6 qershor 2011. I pandehuri është bërë kryetar i komunës së Prizrenit më 3 janar 2008. Në këtë kohë, vendimi fillestar i Gjykatës Supreme nuk ka qenë i ekzekutueshëm pasi që rigjykimi në këtë lëndë ishte në proces. Sipas mbrojtjes, neni 427 paragrafi 2 i Ligjit mbi procedurën kontestuese (1977), në fuqi në atë kohë, ka paraparë se në rast të rigjyimit të gjitha vendimet e mëparshme të gjykatës ndërpriten.

Madje edhe po që se Gjykata Supreme ka vendosur mbi pronësinë e parcelave dhe ndryshimet kanë qenë të regjistruara në kadastrë, gjendja faktike e parcelave nuk ka ndryshuar sepse ato janë ende në posedim të **M.K.**, **M.Q.** dhe **J.A.** Saktësia e të dhënave kadastrale është e parëndësishme dhe mos regjistrimi i ndryshimeve në të drejtat dhe faktet nuk kontribuon për të përfituar dobi pasurore ose për të shkaktuar dëm.

Më tej mbrojtësi paraqet se shuma e dobisë pasurore në pikën 1 është llogaritur gabimisht. Shuma e dobisë pasurore është llogaritur bazuar në qiranë e marrë për qiranë e ndërtesave dhe jo duke u bazuar në një qira të mundshme të ngastrave të tokës.

Lidhur me pikën 2 të aktakuzës, pronësia e parcelës kadastrale me numër 800 “Korishe CZ” ka mbetur në pronësi shoqërore dhe vetëm e drejta për ta shfrytëzuar tokën është transferuar tek organizata “Gulistan”. Aktvendimi nr. 01-370 ishte përpiluar nga një zyrtar ligjor dhe mund të ndodhë që ligji është zbatuar gabimisht. Nuk ka pasur ankesë të parashtruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit ose nga kompania jo ekzistuese e pylltarisë, çfarë do të thotë se nga vendimi nuk është bërë asnjë dëm. Para se të nënshkruhet kontrata, bordi i drejtorëve të komunës ka miratuar kërkesën e “Gulistan” dhe ka ndarë parcelën pa kompensim. Kuvendi komunal e ka

miratuar kërkesën e “Gulistan” në vitin 2009. Në 2011, kuvendi komunal i ka ndarë “Gulistan” parcelën e tokës nga vendi i quajtur “Boka Boka”; prandaj i pandehuri vetëm e ka ekzekutuar vendimin.

Lidhur me pikën 3, mbrojtësi pohon se i pandehuri nuk ka kryer vepër penale, pasi që marrëveshja në mes të komunës dh kompanisë private “Kamila” kurrë nuk ishte realizuar. Pra, kompania private nuk ka përfituar ndonjë dobi pasurore. Prona ishte regjistruar nën ish Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore të Jugosllavisë dhe komuna, në realitet, mund ta shfrytëzojë ose administrojë tokën.

Lidhur me pikën 4, në njërin nga takimet e kryetarit të komunës, zëvendësve dhe drejtorëve të tij, ata kanë urdhëruar drejtorin e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër që me një vendim të ndarë t’i ndalojë ekspertët për kryerjen e ekspertizës gjyqësore në procedurë të gjykatës. Prandaj përgjegjësia penale duhet të ndahet në mes të atyre të cilët e kanë lëshuar vendimin. Për ta dënuar të akuzuarin për pikën 4, në aktvendim është dashur të vërtetohet shkelja e të drejtave të një personi të caktuar. Gjeodezistët e komunës nuk janë të vetmit ekspert në këtë lëmi. Gjykata ka mundur të angazhojë ekspertë të tjerë të cilët ishin në dispozicion për të ndihmuar në padi.

Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtja paraqet se pas shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike, gjykata ka gabuar kur ka nxjerrë përfundimin për përgjegjësinë penale të të pandehurit për secilën akuzë. Ai nxjerr konkluzionin se duke pasur parasysh se i pandehuri nuk ka kryer vepër penale, sanksioni i shqiptuar penal ndaj tij është po ashtu i kundërligjshëm.

Mbrojtja propozon që të aprovohet ankesa aktuale dhe të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që i akuzuari **R.M.**, për shkak të mungesës së provave, të lirohet nga të gjitha veprat penale për të cilat është akuzuar, ose aktgjykimi të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

2. Avokati mbrojtës Sahit Bibaj në emër të S.P. më 26 maj 2015 ka parashtruar ankesën e datës 26 maj 2015 pranë Gjykatës Themelore për shkak të:

- Shkeljes së ligjit penal.

Mbrojtja ngrit çështjen e shkeljes së nenit 385 pikave 1.1, 1.2 dhe 1.3. Ai i referohet nenit 339 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe pohon se gjykimi nuk e ka vërtetuar me asnjë provë elementin e përfitimit të dobisë pasurore as për të pandehurin e as për ndonjë person tjetër. Në vend të kësaj, vetëm shoqëria ka përfituar nga ndërtimi i fabrikës së çokollatës sepse kjo ka rritur punësimin, ajo pjesë është kthyer nga një vend mbeturinash në zonë urbane, ka sjellë taksa lokale ndërsa, në përputhje me kontratën, pronësia mbetet e komunës.

Mbrojtja iu referohet disa statuteve, Ligjit nr. 03/L-40 mbi qeverisjen lokale, Ligjit nr. 03/L-090 mbi pronësinë publiko – private dhe Ligjit nr. 02/L -33 mbi investimet e huaja në Kosovë dhe konstaton që kalimi i inkriminuar i shfrytëzimit të parcelës së tokës nr. 688/2 tek personi juridik “Kamila” ka qenë në harmoni me dispozitat e këtyre ligjeve. Në pajtim me këtë, Kosova duhet t’i përmbushë pa u vonuar, në mënyrë rutine dhe pa telashe të gjitha detyrimet të cilat i ka ndaj një investitori të huaj. Për më tepër, qëllimi parësor i këtij ligji duhet të jetë sigurimi i shfrytëzimit më efikas me kosto efektive të fondeve publike.

Në përgjithësi nuk ka prova për ta provuar përgjegjësinë penale të të akuzuarit, ngase ai nuk ishte në dijeni se nënshkrimi i një kontrate të tillë ka qenë i kundërligjshëm. Megjithatë, edhe nëse do të provohej kryerja e veprës penale, ekzistojnë rrethana të cilat e lirojnë nga përgjegjësia penale.

Ai propozon që të anulohet aktgjykimi i apeluar dhe të lirohet i pandehuri nga kjo akuzë ose të pranohet ankesa dhe të kthehet lënda në rigjykim.

3. Avokati mbrojtës Rexhep Hasani në emër të të pandehurit A.A. më 26 maj 2014 ka ushtruar ankesë për shkak të:

- shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike,
- shkeljes së ligjit penal;
- vendimit të gabuar mbi sanksionin penal.

Sa iu përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, mbrojtja konsideron që dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i paqartë dhe i pabazë në veçanti në pjesët të cilat kanë të bëjnë me bashkëkryerjen. As në dispozitiv as në arsyetim të aktgjykimit të apeluar nuk janë dhënë detajet e veprimeve dhe angazhimeve. Ai pretendon se i pandehuri ka marrë

vendimin 07-025-6976Z dhe duke vepruar kësisoj, ai ka pasur një mbulesë ligjore, vendimin e kryetarit të Prizrenit (aktvendimin 01-370, të datës 24 nëntor 2010) dhe kërkesën e drejtorisë administrative të komunës së Prizrenit (nr. 03-3, të datës 24 tetor 2010), për ta bërë ndryshimin në të dhënat kadastrale. Aktet, në bazë të të cilave i akuzuari i ka bërë ndryshimet në të dhënat kadastrale për parcelën kadastrale nr. 800/2 në lokacionin e quajtur “Boka Boka” kanë qenë veprime me autoritet. Prandaj, i akuzuari nuk ka mundur të ndryshojë, të verifikojë apo të ndërmarrë asnjë veprim.

I pandehuri nuk ka qenë i përfshirë as në fillim të bisedave, rreth kërkesës së qendrës arsimore “Gulistan” pasi që nuk ka qenë pjesë e strukturave vendim-marrëse, por vetëm si shërbyes civil. Ai i ka bërë ndryshimet në parcelën kadastrale nr. 800/2 me urdhër të autoritetit. Shërbimet e drejtorisë së kadastrës dhe gjeodezisë e kanë bërë aktvendimin bazë të dokumentacionit valid dhe i akuzuari e ka nënshkruar dhe ka vepruar në bazë të detyrave të tij. Për këtë arsye, i akuzuari nuk ka mundur të ndryshojë, të verifikojë apo të ndërmarrë asnjë veprim tjetër. Në aktgjykim nuk shpjegohet as nuk justifikohet se si është kryer bashkëkryerja e veprës penale në fjalë.

Mbrojtja më tutje i referohet nenit 31 të KPK-së dhe vendimit të përbashkët si kusht i bashkëkryerjes. Mbrojtësi më tutje pretendon se veprimet janë ndërmarrë në mënyrë vullnetare; prandaj, aktgjykimi është, posaçërisht në pjesën e dispozitivit, i paqartë dhe i pajustificuar lidhur me faktet kryesore. Veprimet e ndërmarra nga i pandehuri janë të paqarta, konfuze dhe pa ndonjë argumentim sepse nuk mund të verifikohet se në çfarë mënyre dhe cilat veprime janë ndërmarrë nga i akuzuari. Kështu, gjykata e shkallës së parë i ka shkelur dispozitat e procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, pika 1.12, lidhur me nenin 370, paragrafi 5.5 dhe 7 të KPPK-së.

Në fund, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë. Pa ndonjë provë relevante apo konkrete provohet se i pandehuri ka vepruar në bashkëkryerje të veprave penale së bashku me të akuzuarit **R.M.** dhe **M.K.** Nuk është provuar se i pandehuri si bashkëkryerës i veprës penale ia ka mundësuar komunës së Prizrenit që të marrë në posedim parcelën kadastrale nr. 800/2 dhe ka mundësuar nënshkrimin e kontratës në mes të komunës së Prizrenit dhe QA Gulistan përmes së cilës parcelat kadastrale në fjalë janë dhënë në shfrytëzim.

Për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale – vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike – gjykata e shkallës së parë e ka shkelur ligjin penal në bazë të nenit 385, par. 1, pikës 1.1 të KPPK-së.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart, mbrojtja lidhur me shkeljen e ligjit penal konstaton se gjykata nuk e ka zbatuar nenin 71 të KPK-së dhe gjen se dënimi i tij bazohet vetëm në supozime.

Ai propozon që t'i miratohet ankesa si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar, të kthehet lënda në rigjykim ose të ndryshohet ajo në bazë të dispozitave të nenit 403, par. 1, pikës 1.2 të KPK-së dhe të lirohet i akuzuari nga akuzat e ngarkuara.

4. Avokati mbrojtës Brahim Sopa në emër të të pandehurit K.U. më 20 maj 2014 Gjykatën Themelore ka ushtruar ankesë për shkak të:

- shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- vërtetimit të gabueshëm dhe të pasaktë të gjendjes faktike,
- vendimit mbi sanksionin penal.

Mbrojtja pohon se vendimi i Gjykatës Supreme (aktgjykimi Rev. nr. 209/2005, i datës 26 maj 2006) nuk ka mundur të ekzekutohet për shkak të pengesave ligjore. Në veçanti, në bazë të Ligjit nr. 2003/25, të datës 3 dhjetor 2003, nenit 16, pikës 16.05, bartja e pronës mund të regjistrohet vetëm nëse parcela përkatëse është e lirë nga hipoteka apo nga garancitë e tjera, gjë e cila nuk është në rastin në fjalë të kontestit pronësor. Së dyti, ka pasur konteste gjyqësore të cilat ia kanë parandaluar atij ekzekutimin e aktgjykimit. Për më tepër, ai i referohet nenit 400, par. 1 të LPP-së duke e theksuar se nuk lejohet revizion kundër aktvendimit të apeluar të gjykatës së shkallës së dytë. Ka qenë e pamundur të ekzekutohet ndryshimi kadastral pasi që ka pasur një gabim teknik në vendimin e Gjykatës Supreme, ku nuk iu referohet të gjitha parcelave kadastrale. Parcela 8618 nuk është regjistruar kur të tri parcelat kanë qenë pjesë e procesit të kontestimit gjatë procedurës gjyqësore.

Në fund, ai konstaton se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabueshme dhe jo të plotë dhe i referohet dëshmisë së dhënë nga prokurori publik E.M.

Ai propozon që të aktgjykimi të ndryshohet dhe të lirohet i akuzuari nga përgjegjësia penale.

5. **Avokati mbrojtës Skender Morina në emër të të pandehurit A.T.** më 20 maj 2015 ka dorëzuar ankesën e datës 20 maj 2015 në Gjykatën Themelore për shkak të:

- shkeljes së dispozitave të procedurës penale, sipas nenit 384, par. 1, pikës 1.10 dhe par. 2, pikës 2.1 të KPPK-së;
- shkeljes së ligjit penal, sipas nenit 385, par. 1, pikës 1.1 të KPP-së;
- vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas nenit 386 të KPP-së;
- sanksionit penal – vendimit dhe dënimit.

Mbrojtja deklaron se aktgjykimi në mënyrë esenciale e shkel nenin 384, par. 1, pikën 1.10 të procedurës penale pasi që e tejkalon aktakuzën dhe në këtë mënyrë e bën atë të pakuptueshëm. Ai bie në kundërshtim edhe me veten edhe me provat që dalin nga shqyrtimi gjyqësor prandaj kjo përbën bazë të mjaftueshme për refuzim. Më tutje, aktgjykimi e shkel nenin 384, par. 2, pikën 2.1 të KPP-së, sepse ligji penal është zbatuar gabimisht. I pandehuri është dënuar sipas kodit të ri penal, porse kodi i vjetër është dashur të zbatohet, përkatësisht neni 339, par. 1 i KPP-së. Aktgjykimi përmban shkelje të nenit 385, par. 1, pikës 1.1 të KPP-së, për shkak se veprimet e të pandehurit nuk përmbajnë elemente të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Për më tepër, mbrojtja e vëren se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar gabimisht dhe jo në mënyrë të plotë gjendjen faktike, duke e tejkualuar juridiksionin përkatësisht dispozitivin e aktakuzës. I pandehuri nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të kundërligjshëm. Në veçanti, nuk ekziston asnjë vendim apo ndonjë veprim tjetër juridik administrativ me të cilin i pandehuri i ka parandaluar ekspertët që të mos vijnë në gjykatë. Gjetjet e gjykatës së shkallës së parë janë të pabaza dhe nuk mbështeten në provat materiale. Mbrojtja i referohet procedurës civile dhe pohon se janë shkelur të drejtat e palëve në raport me kërkesat e tyre pronësore. Për këtë arsye vlerësimi dhe gjetjet e gjykatës së shkallës së parë nuk mund të qëndrojnë sepse me zbatimin e këtij konkluzioni, palët nuk kanë qenë të kufizuara apo të pamundësuara që t'i ushtrojnë të drejtat e tyre në gjykim; veprimet e të pandehurit në këtë drejtim nuk kishin ndonjë ndikim në këto lëndë të cilat janë duke pritur për një kohë shumë të gjatë për zgjidhje. Me asnjë provë të vetme apo dokument, nuk është provuar që i pandehuri i ka ndaluar ekspertët që të shkojnë në gjykatë. Në fund, i pandehuri është dashur të shpallet fajtor për ndihmë në kryerjen e veprës penale, dhe jo si kryerës siç është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë.

Ai propozon që aktgjykimi të ndryshohet dhe të lirohet i pandehuri, apo të anulohet aktgjykimi i kontestuar dhe të kthehet për rigjykim.

6. Mbrojtësit Pjetër Pergjoka dhe Bashkim Nevzati në emër të të pandehurit M.K. më 28 maj 2014 kanë parashtruar ankesa në Gjykatën Themelore për shkak të:

- Shkeljes së dispozitave të procedurës penale;
- Shkeljes së kodit penal;
- Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Vendimit mbi veprimin kriminal.

Mbrojtja konstaton se trupi gjykues e ka paragjykuar lëndën dhe se po thujse që në fillim ka ardhur në përfundim se i akuzuari e ka shkelur ligjin. Kjo është e qartë nga arsyetimi i aktgjykimit dhe nga fakti se kolegjit iu deshën vetëm tri orë për ta shpallur aktgjykimin.

Gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në bazë të nenit 384, par. 1.8 të KP-së. Nënshkrimi i një dokumenti plotësues nuk ka fuqi ligjore dhe prova e tillë duhet të konsiderohet e papranueshme. Dëshmia e G.S. është e papranueshme si dhe procesverbali i Bordit të drejtorëve pasi që diskutimet në një forum informal paraqesin mendimin e lirë të pjesëmarrësve. I akuzuari nuk ka marrë pjesë në negociata të cilat kanë të bëjnë me ndarjen e tokës. Regjistrimi i ndryshimeve në listat e kadastrës nuk ka asnjë lidhje me aktivitetet zyrtare të akzuarit.

Aktgjykimi paraqet zbatim të gabueshëm dhe jo të plotë të nenit 370, par. 2, për shkak se nuk e përmban emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, të avokatëve mbrojtës dhe të akzuarit dhe përfaqësuesve të palëve të dëmtuara si dhe datën e hartimit të aktgjykimit. Shkeljet esenciale janë bërë sipas nenit 384, par. 1.12 për shkak të moszbatimit të nenit 370, par. 5, që lidhet me caktimin e dënimeve për secilën vepër penale dhe bashkimin e këtyre veprave për shqiptimin e dënimit unik. Dispozitivi nuk tregon nëse vepra penale është kryer në vazhdimësi apo nëse duhet të jetë përgjegjësi për secilën pikë si dënim unik.

Mbrojtja më tutje parashtron se dëshmitari G.S. e ka pranuar vendimin e kryetarit të komunës dhe pastaj e ka përpiluar dhe e ka nënshkruar dokumentin plotësues. Në vend të dëshmitarit S., i pandehuri nuk ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt në këtë çështje. Nuk ka prova se i akuzuari ka

marrë pjesë në negociatat lidhur me ndarjen e tokës, se ai e ka pranuar vendimin e kryetarit dhe vendimin për ndarjen e tokës. Letrat 03/3 të datës 24 nëntor 2010 dhe 11 shkurt 2011 mund të vlerësohen vetëm si korrespondencë në mes të organeve administrative.

Përfundimisht, as kryetari i komunës as ndonjë zyrtar tjetër zyrtar nuk ua ka ndaluar ekspertëve të gjeodezisë të marrin pjesë në ekspertizën e gjykatës. Prokurori nuk ka siguruar prova lidhur me atë se në çfarë forme është dorëzuar ‘propozimi’ në fjalë, kur është dorëzuar dhe kujt i është adresuar. Procesverbali nga takimi i bordit të drejtorëve mund të konsiderohet si shprehje e mendimit të lirë të pjesëmarrësve por jo si marrje e vendimit. Por edhe nëse vendimi është prezantuar si propozim ai nuk mund t’i obligojë personat e autorizuar. Kryetari i komunës ka nxjerrë një konkluzion, përmbajtja e të cilit nuk është interpretuar drejt nga gjyqtarët.

Ai propozon që të prishet aktgjykimi i kontestuar dhe të kthehet lënda për rigjykim dhe të lirohet i akuzuari në mungesë të provave.

Përgjigjja në ankesë

Prokuroria konstaton se dispozitivi i aktgjykimit jep një përshkrim të qartë dhe të plotë të fakteve vendimtare; nuk ka mospërputhje në mes të gjendjes faktike dhe përmbajtjes së arsytimit të aktgjykimit. Ai parashtron se ankesat në të vërtetë përmbajnë të njëjtat argumente të ngritura disa herë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të adresuar drejt nga prokurorja në fjalën përfundimtare. Duke i pasur parasysh provat e siguruar, nuk ka bazë për kontestimin e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit ofron një përshkrim të qartë dhe të plotë të fakteve vendimtare dhe nuk ka mospajtim në mes të gjendjes faktike në dispozitiv dhe përmbajtjes së arsytimit të aktgjykimit. Dispozitivi së bashku me arsytimin ofron një vlerësim të qartë të provave dhe një vërtetim të saktë të gjendjes faktike. Në fund, gjykata ka përgatitur një vlerësim të arsytuar mirë të provave, duke përfshirë këtu edhe besueshmërinë e dëshmitarëve dhe peshën e deklaratave të tyre për t’i shpallur fajtorë të pandehurit. Gjykata ka shqiptuar dënime proporcionale me peshën e veprave dhe me kryerjen e tyre.

Prokuroria propozon që të refuzohen ankesat dhe të vërtetohet në tërësi aktgjykimi.

Propozimi i prokurorit të apelit

Lidhur me të pandehurin M. prokurori i apelit konstaton se përshkrimi i fakteve të aktakuzës dhe vërtetimi i fakteve në dispozitiv ndryshon në mënyrë të qartë. Në kundërshtim me atë çfarë pohohet në ankesë, dispozitivi në mënyrë të qartë i përshkruan faktet për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor. Duke iu referuar pohimit të mbrojtjes, i pandehuri nuk i ka njohur të gjithë këta të cilët kanë përfituar nga vepra penale në fjalë, prokurori i apelit vëren se i akuzuari e ka njohur së paku një prej këtyre përfituesve – të pandehurin **K.** Komuna më tutje nuk e ka të drejtën e vendosjes së pronësisë edhe pse asetet e organizatës kanë qenë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Fakti që përfitues nga vepra penale është një investitor i huaj nuk i liron zyrtarët nga obligimi i zbatimit të ligjit. Lidhur me ata, të drejtat e të cilëve janë shkelur e nuk kanë kërkuar asnjë kompensim, prokuroria konstaton se mbrojtja nuk e thekson nëse këta persona kanë qenë të njoftuar si duhet për të bërë padi kundër komunës. Së dyti, disa prej palëve të dëmtuara kanë parashtruar kërkesa pronësore juridike. Së treti, mosveprimi i palëve të dëmtuara për nisjen e procedurave juridike nuk ndikon në faktin se të drejtat e tyre tashmë ishin shkelur.

Ai më tutje thekson se çështja lidhur me pengesat të cilat e parandalojnë ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Supreme tashmë është ngritur gjatë gjykimit dhe është adresuar në detaje. Ai pajtohet me arsyetimin e aktgjykimit në këtë drejtim. Kjo dobi pasurore, e përfituar nga K., Q. dhe A., është e saktë. Prokurori i referohet maksimës nemo plus iuris ad alium transferre potest quam ipse habet. Pronari i tokës ka qenë Organizata punuese e pylltarisë, Sharri – OPB Ekonomia e pyjeve dhe Sekretariati federativ i mbrojtjes popullore të Jugosllavisë. Ai e konsideron të parëndësishme se këto organizata nuk ekzistojnë më dhe kjo gjë nuk i bën asetet e tyre të braktisura. Komuna nuk ka pasur autorizim ligjor që ta marrë pronësinë mbi asetet në fjalë as ta transferojë të drejtën e përdorimit mbi këto ngastra. Lidhur me këtë, nuk qëndron argumenti i mbrojtjes së të pandehurit se komuna vetëm ka ekzekutuar vendimin kur ia ka transferuar tokën ‘Gulistanit’. Lidhur me pikën 3, nuk është e domosdoshme që të kryhet vepra penale për ta transferuar shfrytëzimin e tokës dhe për të përfituar dobi pasurore. Neni 422, par. 1, kërkon vetëm qëllim të posaçëm për përfitimin e dobisë pasurore dhe nuk kërkon që kjo dobi pasurore të materializohet.

Fakti se përveç **M.** edhe të tjerët kanë marrë pjesë në sjelljen e vendimit nuk e shton përgjegjësinë e tij personale penale. Për më tepër, dispozitivi i referohet lëndëve të caktuara civile. Ndalesa ka shkaktuar vonesa në këto lëndë dhe ka ndërhyrë në zhvillimin normal të procedurës gjyqësore. Kjo përbën shkelje të të drejtave të palëve të përfshira.

Prokurori i apelit në fund nuk pajtohet me konkluzionin e mbrojtjes lidhur me shkeljen e ligjit penal gjatë vërtetimit të përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe gjatë caktimit të sanksionit penal kundër tij.

Lidhur me të pandehurin P. prokurori i apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë i ka adresuar argumentet e mbrojtësit, të bëra në aktgjykim. Ai konstaton se kompania private “Kamila” ka përfituar dobi pasurore nga fitimi i së drejtës për shfrytëzim të ngastrës tokësore nr. 688/2 pa asnjë pagesë për dhjetë vjet. Fakti që i akuzuari nuk ka përfituar nga vepra është vlerësuar si rrethanë lehtësuese nga gjyqtari i lëndës. Kontrata pastaj nuk ka qenë në harmoni me ligjin dhe ka shkelur ligjin mbi qeverisjen lokale, ligjin mbi pronësinë publike – private dhe ligjin mbi dhënien dhe këmbimin e pasurisë së paluajtshme të komunës. Gjykata në mënyrë të mjaftueshme e ka vërtetuar përgjegjësinë penale të të pandehurit kur ai i është shmangur komunës së Prizrenit. Kompania private “Kamila” më tutje nuk e ka përmbushur kriterin për t’u liruar nga procedura e prokurimit pasi që nuk është institucion qendror i Kosovës.

Mbrojtja gabon në ligjin substancial kur e sheh të domosdoshme që të vërtetohet kryerja e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit për t’u përfituar dobia pasurore për vete apo për palë të treta. Neni 422, par. 1 i KPP-së kërkon vetëm *dashjen* e posaçme për të përfituar dobi pasurore por jo edhe pranimin e kësaj dobie. Prokuroria e apelit në fund e konteston pohimin e mbrojtjes se i pandehuri nuk ishte në dijeni që kontrata në fjalë ka qenë e kundërligjshme.

Lidhur me të pandehurin A. prokurori i apelit konstaton se dispozitivi në mënyrë të qartë e thekson se veprimet e të pandehurit **A.** kanë kontribuar në mënyrë substanciale në kryerjen e veprës. Mbrojtja nuk i është referuar asnjë organi në ankesën e tyre. Neni 31 i KPRK-së nuk kërkon një plan fillestar apo marrëveshje paraprake që bashkëkryerësit të veprojnë njëri me tjetrin. Mbrojtja nuk ka ngritur asnjë argument të ri i cili nuk është adresuar nga gjykata. Për më tepër, sugjerimi i mbrojtjes për një dënim unik është i pakuptueshëm.

Lidhur me të pandehurin U. prokurorja e apelit i referohet pengesave të ngritura për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Supreme. Sipas mendimit të saj, gjykata e shkallës së parë e ka shtjelluar gjerësisht çështjen në fjalë.

Lidhur me të pandehurin T. prokurori i apelit vëren se gjykata e shkallës së parë nuk e ka tejkaluar akuzën. As gjykata nuk ka konstatuar se i pandehuri ka marrë pjesë në vendimmarrje apo në sjelljen e konkluzioneve. I pandehuri në fakt e ka shpërndarë “konkluzionin” në mesin e ekspertëve të gjeodezisë të drejtorisë së vet, duke u pajtuar me të dhe në mënyrë substanciale duke kontribuar për implementimin e saj. Ai ka qenë i bindur për veprat penale sipas nenit 339, par. 2 të KPK-së, për shkak se gjykata në mënyrë eksplicite ka vërtetuar se në këtë lëndë kodi i ri penal nuk është kod më i favorshëm.

Lidhur me të pandehurin K. prokurori i apelit konstaton se parashtesa e avokatëve mbrojtës mbi paragjykimin e pohuar të trupit gjykues është parashtesë e paafatshme dhe po ashtu e pabazë sepse nuk ka asnjë bazë ligjore siç kërkohet me nenin 41, par. 5. Parashtesat lidhur me papranueshmërinë e disa provave po ashtu nuk kanë bazë ligjore. Mungesa e emrit, mbiemrit të prokurorit të shtetit, të mbrojtësve dhe të përfaqësuesve ligjorë nuk e bën tërë aktgjykimin e pavlefshëm dhe nuk përbën shkelje esenciale. I pandehuri është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit *në vazhdimësi*. Për këtë arsye, ndaj tij mund të shqiptohet vetëm një sanksion penal. Ai nuk e kupton logjikën e parashtesës se një dënim i vetëm unik është dashur të shqiptohet kundër të pandehurit. Në fund, rendi i ditës i mbledhjes së mbajtur më 2 gusht 2011 nuk ka përcaktuar pjesëmarrjen e ekspertit të gjeodezisë. Kjo është parashtruar nga i pandehuri në mënyrë *ad hoc*.

Prokurori i apelit pajtohet me përgjigjen e parashtruar nga prokuroria dhe propozon që të refuzohen ankesat e të gjithë të pandehurve si të pabaza dhe të vërtetohet në tërësi aktgjykimi.

III. Gjetjet

Aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe duhet të anulohet. Për këtë arsye lënda kthehet në rigjykim.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur për ankesat sipas nenit 17 dhe nenit 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).

Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit nr. 03/L-053 mbi juridiksionin dhe kompetencat të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Pranueshmëria e ankesave

Ankesat janë të pranueshme. Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 13 mars 2014 dhe i njëjti i është dorëzuar i shkruar të pandehurit **R.M.** më datë 13 maj 2014, të pandehurit **S.P.** më 13 maj 2014, të pandehurit **A.A.** më 14 maj 2014, të pandehurit **K.U.** më 16 maj 2014, të pandehurit **A.T.** më 16 maj 2014 dhe të pandehurit **M.K.** më 15 maj 2014. Ankesat janë parashtruar nga avokati mbrojtës Ruzhdi H. Berisha në emër të të pandehurit **M.** më 27 maj 2014, nga avokati mbrojtës Sahit Bibaj në emër të të pandehurit **P.** më 27 maj 2014, nga avokati mbrojtës Rexhep Hasani në emër të të pandehurit **A.** më 27 maj 2014, nga avokati mbrojtës Brahim Sopa në emër të pandehurit **U.** më 20 maj 2014, nga avokati mbrojtës Skender Morina në emër të të pandehurit **T.** më 20 maj 2014 dhe nga avokatët mbrojtës Pjetër Pergjoka dhe Bashkim Nevzati në emër të të pandehurit **K.** më 28 maj 2015. Ankesat e të gjithë mbrojtësve janë parashtruar në kohë brenda afatit 15-ditë sipas nenit 380 (1) të KPP-së dhe nga personat e autorizuar.

Shkelje esenciale të nenit 370 par. 1 dhe 2 të KPP-së

Sipas nenit 370 par. 1 të KPP-së, aktgjykimi përfshinë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin. Hyrja e aktgjykimit përfshin të dhënat e përshkruara në paragrafin 2 të këtij neni, cilësimin juridik të veprës penale sipas Kodit Penal si edhe të dhënat e çdonjërit që merr pjesë në shqyrtimin gjyqësor, emrat dhe mbiemrat e të cilëve duhet të shkruhen bashkë me funksionet e tyre procedurale penale në procedurë.

Nga aktgjykimi i shkallës së parë mund të vihet re se hyrja e aktgjykimit nuk i përmban plotësisht këto elemente të cilat përcaktohen me Kodin e Procedurës Penale pasi që në të është

futur në tërësi aktakuza e ngritur nga prokuroria, e që nuk është në përputhshmëri me dispozitat e KPP-së. Neni 370 par. 2 i KPP-së në mënyrë të qartë parasheh që: “Hyrja e aktgjykimit përfshin: shënimin se aktgjykimi merret në emër të popullit, emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit dhe të anëtarëve të trupit gjykues dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën i akuzuari është dënuar dhe nëse ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ditën e shqyrtimit gjyqësor, nëse shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe të përfaqësuesit të autorizuar të cilët kanë qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, datën e shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar dhe datën e përpilimit të aktgjykimit.”

Aktgjykimi i kundërshtuar nuk i përmban disa prej këtyre elementeve të përmendura më sipër: emrin dhe mbiemrin e procesmbajtësit, nëse i akuzuari ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, emrin dhe mbiemrin e mbrojtësit të të akuzuarit dhe datën e përpilimit të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit vë në pah se po që se shkelja e procedurës penale do të limitohej vetëm me këto lëshime atëherë nuk do të kishte arsye ta kthej lëndën prapa në rigjykim sepse të gjitha elementet relevante edhe ashtu janë të pranishme në shkresat e lëndës. Këto shkelje më së miri mund të zgjidhen me ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Megjithatë Gjykata e Apelit vëren edhe shkelje të tjera të cilat janë përmendur më poshtë. Duke i marrë në konsideratë të gjitha shkeljet, Gjykata e Apelit nxjerr përfundimin se epilogu i përgjithshëm e bën të nevojshme prishjen e aktgjykimit dhe kthimin e lëndës në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Shkelje esenciale të nenit 384 par. 1 pikës 1.12 lidhur me nenin 370 par. 6 dhe 7 të KPP-së

Aktgjykimi përmban shkelje esenciale të nenit 384, par. 1, pikës 1.12, lidhur me nenin 370 par. 6 dhe 7 të KPP-së për shkak se dispozitivi është i pakuptueshëm, i paqartë dhe kundërthënëse me arsyetimin dhe faktet vendimtare të paraqitura nga gjykata e shkallës së parë. Në mënyrë specifike, është e paqartë se cilat fakte dhe veprime janë vërtetuar me cilat prova nga Gjykata Themelore sepse nuk ka asnjë përshkrim faktik i cili do të mund t'i qartësonte veprimet e caktuara inkriminuese të të akuzuarit.

Sipas nenit 370 par. 6 të KPP-së dhe lidhur me arsyetimin e një aktgjykimi, gjykata duhet të paraqes arsyet për secilën pikë të veçantë të aktgjykimit. Sipas nenit 370 par. 7 të KPP-së, gjykata duhet ta thotë në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i konsideron të provuara apo jo të provuara, si edhe arsyet për këtë. Gjukata duhet të bëjë edhe vlerësimin e besueshmërisë së provave kundërthënëse, arsyet për mosmiratimin e propozimeve individuale të palëve, si dhe arsyet për të cilat gjykata është udhëzuar në vendosjen e pikave të ligjit, e në veçanti, në vërtetimin e ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarve si edhe në zbatimin e dispozitave specifike të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprimit të tij ose saj.

Gjukata e Apelit përshkruan se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të sjell arsyetim rreth saktësisë së provave kundërthënëse dhe provave mbështetëse për të cilat gjykata nuk i ka aprovuar propozimet konkrete të palëve. Në veçanti, arsyetimi nuk është i mjaftueshëm kur vërtetohet ekzistimi i veprës penale si edhe përgjegjësia penale e të akuzuarit dhe kur zbatohen dispozita përkatëse të ligjit penal për të akuzuarit dhe veprimet e tyre.

Nga dispozitiv nuk është e kuptueshme se kush dhe në çfarë mase të pandehurit kanë përfituar nga veprimet dhe kush është pala e dëmtuar. Dispozitivi i aktgjykimit nuk arrin të identifikojë palët e dëmtuara në mënyrë qartë, e që është arsyeja pse palët e tilla të dëmtuara udhëzohen që të paraqesin kërkesë pronësore juridike, një mjet juridik të cilin ata kanë të drejtë ta kërkojnë në procedurë civile ose të obligojnë të akuzuarit për ta kompensuar dëmin e tyre, në përputhje me nenin 463, par. 1 dhe 2 të KPP-së. Nga aktgjykimi i shkallës së parë nuk shihet se është thirrur ndonjë përfaqësues i ndonjë pale të dëmtuar për tu deklaruar se a i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe a parashtrajnë kërkesë pasurore-juridike (neni 458 dhe 459 të KPP-së), dhe nëse po në çfarë drejtimi ushtrohet kjo kërkesë- kompensim dëmi, kthim sendi apo anulimin e një veprimi të caktuar juridik (neni 458 par.2 të KPP-së). Andaj në rigjykim, gjykata e shkallës së parë, së pari duhet identifikojë të dëmtuarit, mënyrën se si janë dëmtuar dhe ti ftojë të deklarohen në rrethanat e lartcekura nga neni 458 të KPP-së.

Përveç kësaj, dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin edhe për shkak të vlerave dhe shumave të përcaktuara si dëme apo vlerë e pronave të kërkuara që janë fituar nga persona të caktuar përmes keqpërdorimit të pozitive zyrtare të të akuzuarve.

Dispozitivi i përshkruan veprimet të cilat kanë ndodhur, duke i përfshirë dobitë pasurore në vlerën prej € 30,050 në pikën I të aktgjykimin; vlerën prej € 100,600 në pikën II si dhe vlerën

prej € 40,000 në pikën III. Nga një aktgjykim i tillë nuk mund të kuptohet se kush e ka përfituar këtë profit. A kanë përfituar profit të pandehurit për veten apo për dikë tjetër? Gjatë vlerësimit të bërë, gjykata i referohet profitit të humbur duke e përdorur për gjithë kalkulimin. Nuk është e qartë se çfarë ekspertize ka zbatuar gjykata kur e ka bërë vlerësimin për përcaktimin e vlerës së dëmeve apo vlerës së profitit të humbur. Me fjalë të tjera: nga aktgjykimi nuk mund të kuptohet mënyra në të cilën gjykata e shkallës së parë e ka bërë vlerësimin për përcaktimin e vlerës apo pasurisë dhe profitit të humbur. Megjithatë, është obligim i gjykatës që ta urdhërojë ekspertin për analizë të thellë dhe bazuar në opinionin e tij ta bëjë pastaj vlerësimin e vet duke e bërë të qartë nëse i beson apo jo një analize të tillë. Në fund, gjykata duhet ta ofrojë arsyetimin e detajuar. Gjukata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë pjesërisht nuk i ka respektuar procedurat në fjalë.

Në bazë të nenit 370, par. 6 të KPP-së, gjykata duhet të prezantojë arsyet për secilën pikë të aktgjykimit. Arsyetimi duhet të mbështetet me vlerësimin e lirë të provave dhe shqyrtimit të tyre individual, duke e përfshirë tërësinë e tyre si dhe raportin e ndërsjellë në mes të provave në fjalë. Duhet të specifikohet në mënyrë të qartë se cilat prova kanë qenë pranueshme, për çfarë arsye dhe cilat nuk kanë qenë të pranueshme, ndërsa sa i përket anës ligjore, duhet të interpretohen dispozitat ligjore përkatëse dhe të specifikohen ato. Gjukata e shkallës së parë, siç mund të shihet nga aktgjykimi, p.sh. në faqen 5 në versionin në shqip, ka administruar njëmbëdhjetë (11) prova nga dosja nr. 3; njëzet e dy (22) sosh nga dosja nr. 4; tridhjetë (30) nga dosja nr. 5; tridhjetë e gjashtë (36) nga dosja nr. 6; dhe katër (4) prova nga shqyrtimi gjyqësor; dëshmitë e dëshmitarëve dhe të pandehurve vetëm janë dhënë në listë por nuk janë shtjelluar fare, rishikuar dhe kontrolluar duke i dhënë arsyet pse janë të rëndësishme si dhe lidhjen e tyre shkakore me tërë çështjen penale në përgjithësi si dhe me të akuzuarit në veçanti. Gjukata e shkallës së parë është dashur ta bëjë vetë vlerësimin lidhur me besueshmërinë e secilës provë të administruar. Në veçanti, ajo është dashur të sqarojë se cila provë është vërtetuar me cilën provë dhe cila ndërlidhet me provat e tjera për hir të vërtetimit të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike. Vetëm duke i radhitur provat nuk mund të konstatohet se çfarë ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë dhe me cilat prova si dhe cilat veprime inkriminuese të një prej të akuzuarve apo mbase të gjithëve janë konfirmuar me dëshmitë në fjalë. Faktikisht, gjykata e shkallës së parë nuk ka nevojë t'i ftojë për të dytën herë të njëjtit dëshmitarë të cilët tashmë janë dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor. Gjukata, në vend të kësaj, duhet t'i rishikojë të gjitha dëshmitë një nga një dhe më

pastaj duhet ta vlerësojë besueshmërinë e këtyre dëshmive. Gjykatës i duhet ta vlerësojë lidhjen shkakore të këtyre dëshmive me veprimet e të akuzuarve dhe faktet të cilat janë provuar nga këto prova. Në fund, gjykata duhet t'i harmonizojë ato me provat e tjera dhe, varësisht nga rezultati i tyre, të sjellë vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Shkelja esenciale e nenit 384, pikës 1.12, lidhur me nenin 370 par. 8 të KPP-së

Aktgjykimi, përveç kësaj, përmban edhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sipas nenit 384, pikës 1.12, lidhur me nenin 370 par. 8 të KPP-së, pasi që nuk i përmend rrethanat të cilat janë marrë parasysh nga gjykata kur është caktuar dënimi. Është e paqartë mënyra se si gjykata e shkallës së parë e ka justifikuar dënimin. Cilat rrethana lehtësuese dhe rënduese ekzistojnë dhe duhet të merren parasysh gjatë individualizimit të dënimit? Në bazë të neneve 73 e 74 të KPRK-së, në veçanti kërkohet që të justifikohen rrethanat në të cilat është bazuar shqiptimi i dënimit të dhënë në dispozitivin e aktgjykimit. Gjykata e Apelit konstaton se në pjesën dënuese të aktgjykimit të kundërshtuar, gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë dhe nuk i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese për të akuzuarit. Gjykata ka bërë përshkrimin e veprimeve inkriminuese të të akuzuarve pa i specifikuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat domosdoshmërisht kanë ndikim në lartësinë e dënimit.

Gjykata e shkallës së parë është e lirë në vendimin e saj gjatë vlerësimit të provave përderisa Gjykata e Apelit do ta rivlerësojë atë vetëm nëse konstaton se ka pasur gabime ligjore gjatë vlerësimit të bërë prej gjykatës. Gjykata e Apelit konstaton se aktgjykimi në fjalë nuk përmban vlerësim të mjaftueshëm si dhe përshkrim të mjaftueshëm faktik dhe arsyetim.

Vërejtjet përfundimtare

Nga arsyet e përmendura më lart, aktgjykimi i kundërshtuar është i paqëndrueshëm ligjërisht dhe si i tillë është dashur të anulohet. Për këtë arsye, lënda duhet të kthehet prapa në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Gjatë rigjykimit varet nga gjykata e shkallës së parë nëse do t'iu përmbahet vërejtjeve të përmendura më sipër dhe eliminimit të të gjitha shkeljeve të referuara më lart, që t'i administrojë të gjitha provat dhe t'i vlerësojë të njëjtat në përputhje me dispozitat e

nenit 370, par. 6, 7 dhe 8 të KPP-së dhe pastaj në varësi nga vlerësimi i këtyre provave të arrijë deri tek konkluzionet e mbështetura në provat e administruara para se të marrë vendimin e duhur.

Si përmbledhje, gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë arsyet që kanë të bëjnë me rrethanat lehtësuese dhe rënduese, prandaj kolegji për këtë arsye nuk mund të pajtohet apo të mos pajtohet me dënimin, duke e bërë kështu të papranueshëm për Gjykatën e Apelit. Ankesat në fjalë, për këtë arsye, pranohen ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të Prizrenit P. Nr. 171/13, i datës 13 mars 2014 anulohet. Lënda në fjalë kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Nga të gjitha këto që u theksuan më sipër, vendoset si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Aktvendimi i arsyetuar me shkrim është kompletuar më datën 27 gusht 2015.

Kryetari i kolegjit

Piotr Bojarczuk
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i kolegjit

Abdullah Ahmeti
Gjyqtar kosovar

Anëtar i kolegjit

Dr. Driton Muharremi
Gjyqtar kosovar

Procesmbajtës

Dr. Bernd Franke
Zyrtar ligjor i EULEX-it

Gjykata e Apelit

Prishtinë

PAKR 349/14

22.07.2015